



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 14, datë 22.01.2019

MBI

FILLIMIN E PROCESIT TË KRIJIMIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor i mbledhur më datë 22.01.2019, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efijencës, në ushtrim të kompetencave në lidhje me administrimin e gjykatave, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në funksion të aplikimit të skemës së delegimit dhe asaj të transferimit të përkohshëm, sipas neneve 45 dhe 46 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procesit për krijimin e skemës së delegimit, si dhe, deri në zbatimin e saj, për transferimin e përkohshëm në çdo gjykatë ku evidentohet nevoja për krijimin e trupës gjyqësore në rastin konkret.
2. Të kerkohet pëlqimi i të gjithë magjistratëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë, që pa lëvizur nga pozicioni ku është emëruar, për kandidimin në skemën e delegimit sipas nenit 45 të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe për dhënien e pëlqimit për transferimin e përkohshëm sipas nenit 46 të këtij ligji.
3. Dhënia e pëlqimit nga magjistratët të dokumentohet me një deklaratë me shkrim sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, ku të evidentohet qartë pëlqimi i tij sa i përket kandidimit në skemën e delegimit dhe/ose për transferimin e përkohshëm.
4. Dhënia e pëlqimit me shkrim nga magjistratët të depozitohet, brenda datës 25.01.2019, pranë Kryetarit të Gjykatës ku magjistrati ushtron funksionin.
5. Kryetari i Gjykatës brenda datës 26.01.2019, depoziton deklaratat për dhënien e pëlqimit të magjistratëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
6. Në mungesë të dhënies nga magjistratët të pëlqimit sipas nenit 45, 46 të Ligjit, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të fillojë procedurat sipas nenit 46 pika 2 të Ligjit “Për Statusin e

Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për përmbushjen e nevojave të Gjykatave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE